| | | |
|---|---|---|
| Republika e Kosovës<br>Republika Kosova<br>Republick of Kosova | **DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS**<br>Nr. I lëndës 11-351-9340/35 — Datë: 14.04.2022 | **Komuna e Istogut**<br>Opstina Istok<br>Municipality of Istog |

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-l 10 dt. 31.05.2012, nenit 21,22 & 44, të Ligjitpër Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.O5/L-031 dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Istogut 01Nr. 62/2010, 30.11.2010 Udhëzimit Admnistrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura me nr. të kërkesës 11-351-9340 të dt. 09.03.2022 në emër të pronarëve Ruzhdi Behlulaj nga Banja, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedis në Istog lëshon këtë:

# VENDIM PËR LEJE NDËRTIMORE

| **Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:** | | | |
|---|---|---|---|
| Emri: | Ruzhdi Behlulaj nga Lubova | | |
| Adresa: | rr. "Bardh Isufi" në Banjë, Komuna e Istogut | | |
| Telefoni: | [redacted] | Emaili: | |

| Emri i Projektit: | **NDËRTESË BANIMI INDIVIDUAL P+0K** | | |
|---|---|---|---|
| Emri i Projektuesit: | 1. **Drilon Isufi, ark. bch**<br>2. **Halit Kabashi, idgj** | | |
| Adresa: | Studio projektuese "Arch-ART" rr. "Ibrahim Rugova" në Istog | | |
| Telefoni: | [redacted] | Emaili: | |

| **Për punët ndërtimore në vijim:** | | |
|---|---|---|
| Adresa: rr. "Bardh Isufi" në Banjë | | |
| Zona(t) Kadastrale: Lubovë | Nr. i parcelave kadastrale: 00727-10 | GPS Koordinatat: |

| Lloji i ndërtimit të propozuar: | |
|---|---|
| Ndërtim i ri ☒ Rindërtim ☐ Riparim ☐ | |
| **Kategoria e ndërtimeve të propozuara:** | |
| Kategoria I ☒ Kategoria II ☐ | |
| **Përdorimi i propozuar:** | A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po ☐ Jo ☐ |
| Përshkrimi: Ndërtesë e banimit individual P+0K në Banjë | |

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore Ruzhdi Behlulaj pronar lejohet ndërtimi i Ndërtesë e banimit individual P+0K në Banjë

**Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:**

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë se saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese ne vendndertim me informatat e mëposhtme:
  - informata mbi Lejen Ndërtimore
  - informatat mbi projektuesin
  - informata mbi kontraktuesin
  - prezantimi grafik i dukjes se ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
  - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
  - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
  - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
  - projektin kryesor me te gjitha faza për nevoja te realizimit te ndërtimit;
  - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
  - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
  - protokollet e miratuara te nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
  - Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
  - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
  - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor te miratuara nga projektuesi përveç në rastet kur:

- o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me KN, Kodin dhe rregulloret teknike ne fuqi;
- o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
- o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;

- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

## A r s y e t i m

Aplikuesi Ruzhdi Behlulaj nga Banja, me nr. të kërkesës 11-351-9340 të dt. 09.03.2022 ka kërkuar nga organi kompetent DPUM lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin, Ndërtesë e banimit individual P+0K, parcela nr. *00727-10 ZK Lubovë* në Banjë.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr.02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për **lëshimin e Lejes Ndërtimore**, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Dokumentacioni pronësoro juridik
- Tri kopje të projektit ideor dhe kopje elektronike - për Kategorinë e I-rë
- Dëshmi mbi zotimin e mjeteve për pagesën e taksave
- Te tjera

**Shtojcë:** Lejës së ndërtimit i bashkëngjitet: situacioni i ngushtë, dispozita urbanistike e pozicionimit të bobjektit me koordinata, në sistemin koordinativ KOSOVAREF01.

**Udhëzim juridik:** Pala e paknaqur me këtë vendim, përnes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet MMPHI në Prishtinë brenda afatit prej 30 ditësh bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet: parashtruesit të kërkesës QSHQ, kësaj Drejtorie, Drejtorisë për inspektim dhe Arkivës.

Udh. I sektorit
Ark. Rexhep Blakaj id.

Drejtor
Dukagjin Hoxhaj,

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
REPUBLIKA KOSOVO OPSTINA ISTOG

| Republika e Kosovës<br>Republika Kosova<br>Republic of Kosova | DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS | | Komuna e Istogut<br>Opstina Istog<br>Municipality of Istog |
|---|---|---|---|
| | Nr. 11-351-9340/39 | Dt. 16.03.2022 | |

## Drejtoria e Planifikimit urban dhe mjedis

Rr. „Fadi ferati " pn.121, Tel.03820043844
Email: rexhep.blakaj@rks-gov.net

### LISTË E DISTRIBUIMIT/CIRKULARNO PISMO/ROUTING SLIP

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **REFERENCË:** | | Nr. 11-351-9340/39 (zyrtare) | | | |
| **PËR/ZA/TO:** | | Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi,<br>Z. Ismet Hasi përgjegjës për kadastër | | | |
| **CC:** | | | | | |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | | Dukagjin Hoxhaj, Drejtor | | | |
| **NGA/OD/FROM:** | | Rexhep Blakaj, Udhëheqës i sektorit | | | |
| **TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:** | | | | | |
| **Nr.i zyrës<br>Br. kancelarije<br>Room No.:** | **DPUM** | **Lokacioni:<br>Kucni:<br>Extension:** | | **Data:<br>Datum:<br>Date:** | 16.03.2022 |
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION | | | | | x |
| SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZAHTEVANO/AS REQUESTED | | | | | x |
| SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN | | | | | x |
| AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE | | | | | I pa caktuar |

## Njoftim:

Sipas kërkesës të pronarit Ruzhdi Behlulaj me nr. 11-351-9340 të dt. 16.03.2022 për Leje ndërtimore dhe duke u bazuar në Ligjin për Ndërtim, Nr. 04/L-110, Ligjit të Planifikimit Hapësinor 04/L-174, Ligjit për ruajtjen e tokës bujqësore, neni 11, 13 dhe 14 si dhe neni 8, 9 dhe 14 të UA 41/2006 për ndërrim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore dhe Ligjit për Procedurën Administrative, Nr. 05/L-031 si dhe pagesat e bëra për parcelën me nr. 0000727-10 *ZK Lubovë* dhe sipërfaqe prej S=715m$^2$ të cilat janë të destinuara Zonë ndërtimore sipas PZHK të miratuar nga Kuvendi i Komunës në Istog me nr. të referencës 01 Nr.131/019 të dt. 31.10.2019, ua dërgojmë në kompetencë.

Në shtojcë të këtij komunikimi iu dërgojmë shkresat e kërkuar të bashkangjitura në kërkesë.

Me respekt !